

<p align="center">ARTICLES OF INCORPORATION OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY "GOLDEN BUILD" SH.P.K.</p>	<p align="center">AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "GOLDEN BUILD" SH.P.K.</p>
<p>Today, on 15.06.2026, the following founding shareholders: - Mr. Mazen ALHAMMADI, Syrian citizen, born on 20.09.1976, holder of passport no. N02215435, in major age with full capacity to act; - Ms. Shahed ALHAMMADI, Syrian citizen, born on 17.04.2008, holder of passport no. N02215445, in major age with full capacity to act; in accordance with the applicable legislation of the Republic of Albania, agree to set up a Limited Liability Company denominated "GOLDEN BUILD" Sh.p.k. (hereinafter also the "Company"), by signing these Articles of Incorporation. The activity of this Company will be performed pursuant to Albanian laws and its Articles of Association, which constitute an integral part of these Articles of Incorporation.</p>	<p>Sot më datë 15.06.2026, ortakët e mëposhtëm themelues: - Z. Mazen ALHAMMADI, shtetas Sirian, lindur më datë 20.09.1976, mbajtës i pasaportës nr. N02215435, madhor me zotësi të plotë për të vepruar; - Znj. Shahed ALHAMMADI, shtetase Siriane, lindur më datë 17.04.2008, mbajtëse e pasaportës nr. N02215445, madhore me zotësi të plotë për të vepruar; në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, kanë vendosur të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "GOLDEN BUILD" Sh.p.k. (në vijim referuar edhe si "Shoqëria") duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi.</p>
<p align="center">Article 1 Company's Name</p> <p>The denomination of the Company is "GOLDEN BUILD" Sh.p.k.</p>	<p align="center">Neni 1 Emërtimi i Shoqërisë</p> <p>Emërtimi i Shoqërisë është "GOLDEN BUILD" Sh.p.k.</p>
<p align="center">Article 2 Registered Office</p> <p>The registered office of the Company is at Rr. "Nikolla Lena", ND.61, H.30, Kt.1, 1001, Tirana, Albania.</p>	<p align="center">Neni 2 Selia</p> <p>Selia e Shoqërisë është në Rr. "Nikolla Lena", ND.61, H.30, Kt.1, 1001, Tiranë, Shqipëri.</p>
<p align="center">Article 3 Duration</p> <p>The duration of the Company is for an indefinite period of time.</p>	<p align="center">Neni 3 Kohëzgjatja</p> <p>Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është me një afat të pacaktuar.</p>
<p align="center">Article 4 Object of activity</p> <p>4.1 The company shall perform contracting, subcontracting, purchase and sale of building materials and equipment; construction works; participation in undertakings, tenders and contracts.</p>	<p align="center">Neni 4 Objekti i veprimtarisë</p> <p>4.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitet në fushën e kontraktimit, nënkontraktimit, blerjes dhe shitjes së materialeve dhe pajisjeve të ndërtimit; punimeve të ndërtimit; pjesëmarrjes në sipërmarrje, tendera dhe kontrata.</p>
<p align="center">Article 5 Capital</p> <p>5.1 The capital of the Company is ALL 1,000 (one thousand). 5.2 The capital of the Company is divided into 2 (two) quotas, totally subscribed and paid in as follows: - Mr. Mazen ALHAMMADI, Syrian citizen, holder of passport no. N02215435, has contributed in cash to the capital of the Company with a sum equal to ALL 500, which has been paid, representing 1 quota equivalent to 50% of the paid-up share capital. - Ms. Shahed ALHAMMADI, Syrian citizen, holder of passport no. N02215445, has contributed in cash to the capital of the Company with a sum equal to ALL 500, which has been paid, representing 1 quota equivalent to 50% of the paid-up share capital. 5.3 Based on the abovementioned contributions: - Mr. Mazen ALHAMMADI owns 1 (one) quota of the capital, equal to 50% (fifty percent) of the capital of the Company; and - Ms. Shahed ALHAMMADI owns 1 (one) quota of the capital, equal to 50% (fifty percent) of the capital of the Company.</p>	<p align="center">Neni 5 Kapitali</p> <p>5.1 Kapitali i Shoqërisë është 1,000 (një mijë) lekë. 5.2 Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në 2 (dy) kuota, i nënshkruar dhe paguar tërësisht si më poshtë: - Z. Mazen ALHAMMADI, shtetas Sirian, mbajtës i pasaportës nr. N02215435, ka kontribuar në para në dorë në kapitalin e Shoqërisë një shumë të barabartë me 500 LEK, e cila tashmë është paguar, që përfaqëson 1 kuotë të barabartë me 50% të kapitalit themeltar të paguar. - Znj. Shahed ALHAMMADI, shtetase Siriane, mbajtëse e pasaportës nr. N02215445, ka kontribuar në para në dorë në kapitalin e Shoqërisë një shumë të barabartë me 500 LEK, e cila tashmë është paguar, që përfaqëson 1 kuotë të barabartë me 50% të kapitalit themeltar të paguar. 5.3 Në bazë të kontributeve të sipërcituara: - Z. Mazen ALHAMMADI zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit, të barabartë me 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe - Znj. Shahed ALHAMMADI zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit, të barabartë me 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.</p>

<p style="text-align: center;">Article 8 Capital</p> <p>The capital of the Company is ALL 1000 (one thousand). The capital of the Company is divided into 2 (two) quotas, totally subscribed and paid in as follows:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mr. Mazen ALHAMMADI has contributed to the capital of the Company the amount of ALL 500, representing 1 quota equivalent to 50% of the paid-up share capital. - Ms. Shahed ALHAMMADI has contributed to the capital of the Company the amount of ALL 500, representing 1 quota equivalent to 50% of the paid-up share capital. <p>Based on the abovementioned contributions, each shareholder owns 1 (one) quota of the capital, equal to 50% of the capital of the Company.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 8 Kapitali</p> <p>Kapitali i Shoqërisë është 1000 (një mijë) lekë. Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në 2 (dy) kuota, i nënshkruar dhe paguar tërësisht si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Mazen ALHAMMADI ka kontribuar në kapitalin e Shoqërisë shumë 500 LEK, që përfaqëson 1 kuotë të barabartë me 50% të kapitalit themeltar të paguar. - Znj. Shahed ALHAMMADI ka kontribuar në kapitalin e Shoqërisë shumë 500 LEK, që përfaqëson 1 kuotë të barabartë me 50% të kapitalit themeltar të paguar. <p>Në bazë të kontributeve të sipërcituara, secili ortak zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit, të barabartë me 50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.</p>
<p style="text-align: center;">Article 9 Transfer of capital shares / Restrictions on transfer</p> <p>The Shareholders are the exclusive owners of the quotas of the registered capital of the Company. The shares of the registered capital may be transferred, in whole or in part, to third parties only by written deed.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 9 Transferimi i pjesës së kapitalit / Kufizimet në transferim</p> <p>Ortakët janë zotëruesit e vetëm të kuotave të kapitalit të regjistruar. Kuotat e kapitalit të regjistruar mund të transferohen, tërësisht ose pjesërisht, tek të tretët vetëm me shkresë me shkrim.</p>
<p style="text-align: center;">Article 10 Capital increase</p> <p>The Shareholders may increase their contribution in the share of the registered capital. The capital increase may also be made through subscription and payment of new capital shares by new shareholders. New shareholders shall be accepted and approved as such by resolution of the Shareholders.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 10 Rritja e kapitalit</p> <p>Ortakët mund të rrisin kontributin e tyre në kapitalin e regjistruar. Rritja e kapitalit mund të realizohet edhe përmes nënshkrimit të kuotave të reja të emetuara nga Shoqëria nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj do të pranohen dhe të miratohen si të tillë me vendim të ortakëve.</p>
<p style="text-align: center;">Article 11 Decrease of capital</p> <p>Based on the resolution of the Shareholders, decrease of the registered capital shall be made in compliance with the procedures provided by the commercial legislation.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 11 Zvogëlimi i Kapitalit</p> <p>Bazuar në vendimin e ortakëve, zvogëlimi i kapitalit të regjistruar do të bëhet në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni tregtar.</p>
<p style="text-align: center;">GOVERNANCE STRUCTURE Article 12 Shareholders Assembly Resolutions</p> <p>The main decisions of the Company activity are taken by resolutions of the Shareholders, which are registered in the register of decisions of the Company so that the data may not be altered or erased. Only the Shareholders Assembly shall be entitled to decide on the following issues:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) modifications and amendments to these Articles of Association; b) acceptance of new shareholders or transfer of shares; c) increase and/or decrease of registered capital; d) merger, spin-off, dissolution and any kind of transformation of the Company; e) approval of internal management rules; f) appointment and dismissal of the Administrator; g) any other matters reserved by law or these Articles of Association. 	<p style="text-align: center;">STRUKTURA DREJTUESE Neni 12 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve</p> <p>Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë miratohen me vendim të ortakëve, i cili regjistrohet në regjistrin e vendimeve të Shoqërisë në mënyrë që të dhënat të mos ndryshohen apo fshihen. Vetëm Asambleja e Ortakëve ka të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) modifikimin dhe ndryshimin e Statutit; b) pranimin e ortakëve të rinj ose transferimin e kuotave; c) rritjen dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar; d) vendosjen për shkrijen, prishjen, likuidimin dhe/ose çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë; e) miratimin e rregullave të brendshme të administrimit; f) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit; g) çdo çështje tjetër të rezervuar nga ligji ose ky Statut.

<p style="text-align: center;">Article 13 Administration</p> <p>In all domestic and foreign operations, the Company is represented by the Administrator, nominated and replaced by the Shareholders.</p> <p>The Administrator shall have full powers for the ordinary and daily management of the Company and representation before third parties.</p> <p>The first Administrator of the Company, appointed for an initial term of 5 years, is:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mr. Igli ZEPISHTA, Albanian citizen, born on 12.07.1966, holder of the ID no. G60712132V, in major age with full capacity to act. 	<p style="text-align: center;">Neni 13 Administrimi i Shoqërisë</p> <p>Në të gjithë veprimtarinë brenda dhe jashtë vendit, Shoqëria përfaqësohet nga Administratori që emërohet dhe zëvendësohet prej ortakëve.</p> <p>Administratori do të ketë kompetenca të plota për drejtimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe përfaqësimin e saj përpara të tretëve.</p> <p>Administratori i parë i Shoqërisë, i emëruar për një periudhë 5 vjeçare është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Igli ZEPISHTA, shtetas Shqiptar, lindur më datë 12.07.1966, mbajtës i kartës së identitetit nr. G60712132V, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.
<p style="text-align: center;">Article 14 Fiduciary duties and liability</p> <p>The Administrator must perform his duties in accordance with the law, these Articles of Association and the resolutions of the Shareholders, acting in good faith and in the best interest of the Company.</p> <p>The Administrator must prevent and avoid actual and potential conflicts between personal interests and those of the Company, and keep confidential the information of the Company.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 14 Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësitë</p> <p>Administratori duhet të kryejë detyrat e tij në përputhje me ligjin, këtë Statut dhe vendimet e ortakëve, duke vepruar në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të Shoqërisë.</p> <p>Administratori duhet të parandalojë dhe të shmangë konfliktet aktuale dhe potenciale ndërmjet interesave personale dhe atyre të Shoqërisë, si dhe të ruajë konfidencialitetin e informacionit të Shoqërisë.</p>
<p style="text-align: center;">Article 15 Chartered accountant</p> <p>The chartered accountant shall be appointed by resolution of the Shareholders if necessary.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 15 Eksperti Kontabël</p> <p>Eksperti Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Ortakëve, nëse është e nevojshme.</p>
<p style="text-align: center;">Article 16 Financial year</p> <p>The financial year of the Company activity coincides with the calendar year, beginning as of 1st January and ending on 31st December of each year.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 16 Viti Financiar</p> <p>Viti financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.</p>
<p style="text-align: center;">Article 17 Balance sheet / Accounting</p> <p>The balance sheet of the Company is examined by the Shareholder(s) and should be prepared to be submitted to tax authorities before the end of March of the consecutive year.</p> <p>Accounting books should be kept in Albanian language and local currency (ALL). The Company may keep separate accounts in foreign currency, which amounts shall be converted in local currency according to the law.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 17 Bilanci, Mbajtja e Llogarisë</p> <p>Bilanci i Shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku(ët) dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur tek organet tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasardhës.</p> <p>Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, të cilat konvertohen në monedhën vendase sipas ligjit.</p>
<p style="text-align: center;">Article 18 Liquidation</p> <p>The Shareholders may resolve to dissolve the Company.</p> <p>By resolution of the Shareholders shall be appointed a liquidator or a group of liquidators that will handle the liquidation procedures.</p> <p>Liquidator(s) will prepare the liquidation report, which contains an overall economic standing of the Company, the steps of liquidation and the final balance sheet.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 18 Likuidimi</p> <p>Ortakët mund të vendosin të prishin Shoqërinë.</p> <p>Me vendim të ortakëve do të caktohet një likuidues ose një grup likuiduesish që do të merren me procedurat e likuidimit.</p> <p>Likuiduesi(t) përgatit raportin e likuidimit, i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe bilancin përfundimtar.</p>
<p style="text-align: center;">Article 19 Changes to the Articles of Association</p>	<p style="text-align: center;">Neni 19 Ndryshimet në Statut</p>


<p>The provisions of these Articles of Association can be modified by the Shareholders Assembly in compliance with the provisions of the commercial legislation.</p>	<p>Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar.</p>
<p style="text-align: center;">Article 20 Final provisions</p> <p>These Articles of Association are prepared and signed in 2 (two) originals in English language and Albanian language. In case of discrepancies between the two versions, the English language version shall prevail.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 20 Dispozita Përfundimtare</p> <p>Ky Statut është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhjeje në lidhje me dy versionet, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.</p>

Founding Shareholders / Ortakët Themelues

Mr. Mazen ALHAMMADI

Ms. Shahed ALHAMMADI

Mazen ALHAMMADI



Shahed AlHammedi

